

VENDIM
Nr. 139, datë 25.6.2018

PËR MOSPRANIMIN PËR SHQYRTIM TË APLIKIMIT TË SHOQËRISË “KAMENICA HPP” SHPK, PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC “KAMENICË”, ME FUQI TË INSTALUAR 800 kw

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 6, germa “b”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”; nenit 4, pika 2, germa “c”; nenit 10, pika 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, dhe nenit 19, pika 1, germa “a” të “Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, vendimit të bordit të ERE-s nr. 153, datë 11.12.2015 “Mbi operimin në treg të prodhuesve me kapacitet të instaluar nën 1 mw dhe vetëprodhuesve të energjisë elektrike”, bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 25.6.2018, mbasi u njoh me relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut mbi mospranimin e shqyrtimit të aplikimit të shoqërisë “Kamenica HPP” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Kamenicë”, me fuqi të instaluar 800 kw,

konstatoi se:

- Shoqëria “Kamenica HPP” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 431 prot., datë 5.6.2018, ka paraqitur kërkesën për t’u pajisur me licencë në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Kamenicë”, me fuqi të instaluar 800 kw.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 153, datë 11.12.2015, “Mbi operimin në treg të prodhuesve me kapacitet të instaluar nën 1 mw dhe vetëprodhuesve të energjisë elektrike”, ka vendosur:

1. Vetëprodhuesit, të cilët nuk janë të lidhur me rrjetin kombëtar ose kur lidhen në rrjetin kombëtar për qëllime të mirëmbajtjes së njësisë së prodhimit, nuk pajisen me licencë nga ERE.

2. Prodhuesit, përfshirë dhe vetëprodhuesit e energjisë elektrike të lidhur në rrjetin kombëtar, me kapacitet të instaluar deri në 1 mw, nuk pajisen me licencë nga ERE.

3. Kategoritë e prodhuesve dhe të vetëprodhuesve të parashikuar në pikat 1 dhe 2 të këtij vendimi, kanë detyrimin të njoftojnë ERE-n, në çdo rast, që të fillojnë të ushtrojnë veprimtari në tregun e energjisë elektrike.

4. Sa parashikuar më sipër, e gjejmë edhe në nenin 4, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”.

Për sa më sipër, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të mos pranojë shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “Kamenica HPP” sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Kamenicë”, me fuqi të instaluar 800 kw.

2. Shoqëria “Kamenica HPP” sh.p.k., për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Kamenicë”, me kapacitet të instaluar nën 1 mw, nuk pajiset me licencë nga ERE.

3. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti